

**KONTRATE PER SHITJEN  
E KUOTES SE KAPITALIT  
(TË SHOQËRISË "AZ CONSULTING" SH.P.K)**

Sot, me 08 Mars 2021 (dymije e njezet e nje), ditën e Hene, palet e meposhtme, rane dakort te lidhin kete Kontrate per Shitjen e Kuotes se Kapitalit (me poshte quajtur "Kontrata"):

**SHITES:**

- (1) **Enio ZUSI**, atësia Alban, i lindur më 11.09.1995 në Tirane dhe banues në adresen: Rr.Kavajes Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J50911068S, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar (me poshte i quajtur "Shites").
- (2) **Drini ZUSI**, atësia Alban, i lindur më 31.08.1997 në Tirane dhe banues në adresen: Rr.Kavajes Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J70831046S, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar (me poshte i quajtur "Shites").
- (3) **Edea ZUSI**, atësia Alban, i lindur më 19.12.2001 në Tirane dhe banues në adresen: Rr.Kavajes Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal K16219033I, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar (me poshte i quajtur "Shites").
- (4) **Edona BILALI**, atësia Xhavid, e lindur më 13.06.1989 në Shkoder dhe banuese në adresen: Rr.Çerçiz Topulli, Nd. 22, H. 1, Njësia Administrative Nr. 9, , 1017; Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal I95613076A, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar (me poshte i quajtur "Shites").

Dhe

**BLERES:**

- (5) **Alba BERBERI**, atësia Alfred, e lindur më 29.08.1990 në Pogradec dhe banuese në adresen: Rr.Lasgush Poradeci, Nd. 9, H. 1, 7301, Pogradec mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal J058290096A, madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar (me poshte i quajtur "Bleres");

**MEQENESE:**

- A. Shitesit zoterojne 4 kuota qe perbejne 100% te perqindjes se pjesemarrjes ne Kapitalin e shoqerise referuar Ligjit 9901, date 14.04.2008 per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, (i ndryshuar), ne Kapitalin e Shoqerise "AZ Consulting" shpk, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, regjistruar me nr. NUIS L18314501H ne Qendren Kombetare te Biznesit te Republikes se Shqiperise, me seli ne Tirane, Rruga Gjin Bue Shpata, Pallati Aviacionit te Vjeter, shkalla 4, kati 1, ap.16, (me poshte e quajtur "SHOQERIA").
- B. Ne perputhje me Vendimin e Asamblese se Ortakeve Shitesit kane miratuar shitjen e kuotave te tyre tek Bleresi;
- C. Bleresi deshiron te bleje kuotat e Shitesve qe perbejne 100% te kapitalit (me poshte referuar si "kuota target").

Duke patur parasysh sa me lart palet bien dakort per sa vijon:



## **NENI 1 SHITJA DHE TRANSFERIMI I PRONESISE**

- 1.1 Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Shitesit i shesin Bleresit kuotat e tyre qe i korrespondojne me 100% te perqindjes ne Kapitalin e Shoqerise dhe çdo te drejte te lidhur me te dhe/ose qe rrjedh prej saj.
- 1.2 Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Shitesit zhvishen teresisht nga pronesia mbi Kuoten Target dhe te drejtat e tjera qe lidhen me te dhe ose rrjedhin prej saj, perfshire te drejten e votes dhe te dividendit te cilat i kalojne Bleresit Alba Berberi i cili behet pronar i 1 Kuote qe perben 100% te perqindjes se pjesemarrjes ne Kapitalin e Shoqerise.
- 1.3 Shitesit çlirohet teresisht nga te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i Kuotes menjehere me nenshkrimin e kontrates dhe regjistrimin e kalimit te kuotes ne Qendren Kombetare te Biznesit.

## **NENI 2 ÇMIMI I SHITJES DHE MENYRA E PAGESES**

- 2.1 Bleresi bie dakord dhe angazhohet t'i paguaje Shitesve ne total 100,000 (njqind mije) leke si cmim te Kuotes Target se Shitesit (referuar nenit 1.1), (me poshte i quajtur Çmimi i Shitjes).
- 2.2 Shitesit dhe Bleresi deklarojne qe titulli i pronesise mbi Kuoten e Shitesit do kaloje me nenshkrimin e kesaj Kontrate dhe Çmimi i Shitjes eshte paguar cash ndermjet paleve.
- 2.3 Ne fund te transakcionit Shoqeria do te zoterohet nga Alba Berberi do te zoteroje 1 (nje) kuote qe do te perbeje 100% te kapitalit te Shoqerise.

## **NENI 3 DEKLARIME DHE GARANCI**

- 3.1 Shitesit deklarojnë dhe garantojnë se kanë te drejte dhe nuk kanë asnje pengese te çfaredo natyre qe te lidhin dhe zbatojne kete Kontrate dhe se kjo Kontrate perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe per Shitesin.
- 3.2 Bleresi deklaron dhe garanton se ka te drejte dhe nuk ka asnje pengese te çfaredo natyre qe te lidhe dhe zbatoje kete Kontrate dhe se kjo Kontrate perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe per Bleresin. Gjithashtu, Bleresi i pranon Kuotat e Shitesve objekt i kesaj Kontrate ne gjendjen te cilat ato jane dhe nuk ka asnje pretendim ne lidhje me to apo te drejta qe lidhen me to dhe/ose rrjedhin prej tyre. Bleresi garanton Shitesit se parate per pagimin e Çmimit te Shitjes nuk burojne nga asnje aktivitet i kunderligjshem.

## **NENI 4 TE NDRYSHME**

- 4.1 Secila prej paleve do te perballoje shpenzimet e veta ne lidhje me negociimin, nenshkrimin dhe permbushjen e detyrimeve te parashikuara ne kete Kontrate.
- 4.2 Palet angazhohen te regjistrojne menjehere Kontraten ne Qendren Kombetare te Biznesit.
- 4.3 Kjo Kontrate pergatitet dhe nenshkruhet ne tre origjinale me vlere te njejte secili dhe ky akt perben te gjithë marreveshjen e arritur midis paleve, premtimet, deklarimet, garancite ne lidhje me objektin e kesaj Kontrate. Asnje ndryshim i kesaj Kontrate nuk do te jete i vlefshem nese nuk behet me shkrim dhe nenshkruhet personalisht nga palet e kesaj Kontrate apo perfaqesues te autorizuar rregullisht prej seciles nga palet ne fjale. Bleresi dhe Shitesit marrin nga nje origjinal te kesaj Kontrate.

## NENI 5 LIGJI ZBATUES DHE ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

- 5.1 Per çeshtjet te cilat nuk jane parashikuar ne kete Kontrate apo qe mund te rrjedhin prej saj do te zbatohet legjislacioni perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise i cili eshte ligji i zbatueshem per kete Kontrate.
- 5.2 Çdo mosmarrveshje qe mund te linde midis paleve te kesaj Kontrate ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e kesaj Kontrate, nese nuk zgjidhet ne mirekuptim mes vete paleve, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

**SHITESI**

Enio Zusi  
Enio ZUSI

Drini Zusi  
Drini ZUSI

Edea Zusi  
Edea ZUSI

Edona Bilali  
Edona BILALI



**BLERESI**

Alba Berberi  
Alba BERBERI